

PRANUAR MË: 29.01.2024
ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

Nr.No.Br.

02/31



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

RREGULLORE PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA
KOMUNALE PËR VITIN 2024

Malishevë, janar 2024

Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 2 pika c, nenit 17 shkronja e,f, nenit 40 paragrafi 2 shkronja (a,c,g), nenit 82 paragrafi 2 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/15 qershor 2008), nenin 8 të Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.88/25 nëntor 2010), nenit 15 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit nr.04/L-060 për Mbeturina, nenit 22 të Ligjit nr.04/L-110 për Ndërtimin, nenit 29 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr.05/L-087 për Kundërvajtje, nenit 63 të Ligjit nr.04/L-003 për Gjendjen Civile, nenit 22 të Ligjit nr. 04/L174 për Planifikimin Hapësinor, dispozitave të Rregullores nr.01/489 të datës 20.04.2010 për Mirëmbajtjen e Pastërtisë në Territorin e Komunës së Malishevës, dispozitave të ligjitvNr.06/L-024 për trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, Statutit të Komunës së Malishevës Nr.02/441 të datës 14/09/2023, neni 15, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur, më 26.01.2024, miraton këtë:

RREGULLORE

PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE PËR VITIN 2024

I. DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen kriteret për obliguesit, mënyra e llogaritjes, lartësia e tarifave, afatet e pagesës, arkëtimi, evidentimi dhe mbikqyrja e ngarkesave, lirimet nga taksat, dispozitat ndëshkuese dhe ankesat në ngarkesat e caktuara në bazë të kësaj Rregulloreje.

Neni 2

Caktohet lartësia e taksave, ngarkesave dhe gjobave për shërbime publike komunale, nevoja tjera për persona fizik dhe juridik që ushtrojnë aktivitet ekonomik dhe jetësor në territorin e Komunës së Malishevës, si:

- 2.1. Personat të cilët paraqesin kërkesë për vërtetime, certifikata të ndryshme, deklarata dhe parashtrësia tjera para organeve të Administratës komunale;
- 2.2. Personat fizik dhe juridik, bizneset të cilët ushtrojnë veprimtari fitimprurëse në territorin e Komunës së Malishevës;
- 2.3. Personat të cilët bëjnë bartjen e të drejtës së pronës përmes transaksioneve;
- 2.4. Personat fizik apo juridik për ndërtimin e ndërtesave individuale apo kolektive për banim dhe afarizëm;
- 2.5. Personat që paraqesin kërkesë për caktimin e kushteve urbanistiko-teknike, leje ndërtimore etj;
- 2.6. Personat që kërkojnë ndërrimet e destinimeve të parcelave të tokës;
- 2.7. Personat dhe subjektet, të cilët janë shfrytëzues të përkohshëm të tokës dhe pronës për ndërtim apo pa ndërtim;
- 2.8. Personat apo subjektet, të cilët kërkojnë shërbime të kadastrit dhe gjeodolisë;
- 2.9. Subjektet të cilët merren me shfrytëzimin e resurseve natyrore;
- 2.10. Personat apo subjektet për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike për biznes, tregje, parkingje, ekspozim publik të vitrinave reklamuese, lojëra argëtuese etj.;

Neni 3

Lartësia e taksave dhe ngarkesave që do të paguajnë qytetarët, personat fizik dhe juridik, në emër të shërbimeve komunale që ju ofrohen janë pjesë e kësaj Rregulloreje dhe shënohen sipas drejtorive përkatëse.

Neni 4

Tarifat e taksave janë shuma fikse, ndërkaq llogaritja (caktimi), dhe pagesa e tyre në bazë të kësaj Rregulloreje për obliguesin bëhet me rastin e dorëzimit të kërkesës nga ana e personave të ndryshëm dhe me dorëzimin e dokumentit zyrtar mbi ngarkesën e caktuar të dorëzuar te subjekti.

Neni 5

Obliguesit duhet t'i paguajnë ngarkesat në afatet e caktuara te bankat në llogarinë përkatëse të Komunës sipas dokumentit dhe shërbimit që bëjnë organet kompetente të Komunës për secilin person fizik apo juridik.

Neni 6

Subjekti mund të bëjë ankesë ndaj Vendimit të lëshuar nga komuna, nëse konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij. Procedura e ankesës zhvillohet në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 126 e 127 të Ligjit Nr..02/L-28 për Procedurën administrative .

Neni 7

Ndaj Vendimit të marrë nga komuna, pala mund të kërkojë të drejtën edhe në procedurë gjyqësore në pajtim me ligjet e zbatueshme në fuqi.

DREJTORIA PËR INSPEKTORAT

Neni 8

Drejtoria e Inspektoratit pas verifikimit dhe marrjes së informative me shkrim nga Drejtoria e Ekonomisë ,se personi përgjegjës i subjektit afarist nuk e ka paguar taksen komunale me rregull, do t'i lëshoj vërejtje me shkrim për pagesë të taksës komunale, përndryshe në rast të mos pagesës së taksës komunale pasojnë masat e tjera ligjore.

Neni 9

Subjektet afariste apo personat fizik të cilët vendosin pano apo tabela te ndryshme në shtylla të ndryshme, trotuare, buzë rrugëve apo në hapësira publike për reklamime të ndryshme, pa pëlqimin e organit kompetent komunal, do të dënohen me gjobë mandatore prej 100.00 €, nga Drejtoria e Inspektoratit si dhe do të hiqet dhe asgjësohet panoja reklamuese. Ndërsa në rast të mos pagesës së gjobës mandatore ndaj personit përgjegjës do të iniciohet procedura përmbarimore.

Neni 10

Për tentim të mosdeklarimit të hapësirës së shfrytëzuar biznesore dhe mos paraqitjen e veprimtarisë tjetër që ushtrohet në kuadrin e atij subjekti, ndaj pronarit apo personit përgjegjës do të iniciohet procedura në gjykatën kompetente.

Neni 11

11.1. Personi përgjegjës i subjektit afarist pas kalimit të afatit ankimor të vendimit , në pagesën e taksës komunale dhe vërejtjeve me shkrim nga DEF apo DI nuk e benë pagesën e taksës komunale, Drejtoria e Ekonomisë dhe Finacave , inicon procedurën përmbarimore.

11.2. Procedura sipas nenit 11.1 të kësaj Rregulloreje do të inicohet për borgjin e mbetur para se i njejtë të mos jetë paguar deri në ndryshimin e kësaj Rregullore e cila i ka liruar nga taksat komunale subjektet afariste.

Neni 12

Drejtoria e Inspektoratit shqipton edhe këto gjoba mandatore

12.1.	Emërtimi	Tarifa
1.	Personi Fizik për transport të udhëtarëve me, kombi taksi dhe auto taksi pa leje (vendim) nga organet kompetente	50.00 €
	Personi Fizik me autobus/minibus ,pa leje(vendim)nga organet kompetente	150.00 €
2.	Për ekspozim të mallit në vende jo të destinuar	50.00€
3.	Shfrytëzimi jo-racional i ujit nga personat fizik	100.00 €
4.	Shfrytëzimi jo-racional i ujit nga:	
	1. Subjekti afarist (biznes individual)	150.00 €
	2. Personi përgjegjës i subjektit afarist	50.00 €
5.	Për hedhje të mbeturinave inerte dhe komunale në vendin jo të duhur	200.00 €
6.	Për vendosje të panos reklamuese pa pëlqim nga organet kompetente Komunale, hedhje, vendosja e gjësendeve të ndryshme në hapësirat e ndryshme publike, ndotja e rrugëve të asfaltuara nga mjetet motorike	100.00 €
7.	Për mallrat me afat të skaduar , të dëmtuara, pa deklaracion, afat i shlyer, mospërputhje e çmimit raft-ark.	
	1. Subjekti afarist (biznes individual)	150.00 €
	2. Personi përgjegjës i subjektit afarist	100.00 €
8.	Mos parkimi i kompanive transportuese në Stacionin e Autobusëve	
	1. Kompania Transportuese-subjekti afarist	50.00 €
	2. Personi përgjegjës i subjektit afarist	50.00 €
9.	Mos respektimi i orarit të punës, kujdestarisë	
	1. Subjekti afarist (biznes individual)	50.00 €
	2. Personi përgjegjës i subjektit afarist	50.00 €
10.	Prerja e asfaltit, vendosja e pengesave, dëmtimet tjera të rrugëve, trotuareve, heqja e dheut pa pëlqimin nga organet kompetente komunale	250.00 €
11.	Dëmtimi i drunjëve-pemëve dekorative , parqeve në qytet dhe fshatra	50.00€
12.	Mosrespektimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave nga kompania përgjegjëse , mospastrimi i mirë i mbeturinave, si dhe pikës së mbledhjes së mbeturinave (afër dhe përreth kontejnerëve në tokë)	
	1. Kompania e grumbullimit të mbeturinave	200.00 €
	2. Personi përgjegjës i kompanisë	100.00 €
13	Mos rregullimi i dëmtimit të rrugëve edhe pas pëlqimit për prerje	150.00 €
14	Mos regjistrimi i subjektit afarist pas afatit të urdhëresës nga inspektorati	100.00 €

12.16. Gjjobat mandatore të parapara në nenin 12 të kësaj Rregullore janë paraparë si Kundërvajtje të lehta sipas nenit 29 paragrafi 5 i Ligjit nr.05/L-087 për Kundërvajtje.

12.16. (a). Shqiptimi i sanksioneve kundërvajtëse bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi për kundërvajtjet.

12.16. (b) Me rastin e pagimit të gjobës, në afatin e përcaktuar me urdhrin kundërvajtës, i dënuari lirohet nga pagimi 50% nga shuma e gjobës së shqiptuar. Nëse personi kundërvajtës nuk e paguan në tërësi ose nuk e bën pagesën e gjobës në afatin e përcaktuar zbatohet procedura siç është e paraparë në Ligjin për Kundërvajtje.

12.16. (c). Për kundërvajtje të personit Juridik parashihet VETËM sanksioni kundërvajtës me gjobë.

12.6. (d). Për personat fizik, personat fizik që ushtrojnë biznes individual apo personat përgjegjës të personave juridik PËRVEÇ shqiptimit të gjobave parashihen edhe masa tjera të parapara sipas Ligjit për Kundërvajtje

12.17. Për kërkesë të daljes në terren të inspektorëve për vërtetimin e gjendjes faktike në buxhetin e Kuvendit të Komunës paguhet tarifa për shërbim, dhe atë:

1. Të gjithë operatorët e telefonisë, bankat dhe organizatat tjera financiare, distributorët e energjisëTarifa 100.00 €
2. Kompanitë publike.Tarifa 50.00 €

12.18. Për dhënien e pëlqimeve të kushteve minimale teknike do të janë këto pagesa deri në miratimin e rregullores për kushte tek.min:

1. Për objektet lokale të punës në sipërfaqe deri 20 m² 10.00 €.
2. Për objektet lokale të punës në sipërfaqe prej 21-50 m² 20.00 €.
3. Për objektet lokale të punës në sipërfaqe prej 51-100 m² 30.00 €.
4. Për objektet lokale të punës në sipërfaqe mbi 100 m² 50.00 €.

12.19. Për dhënien e vërtetimeve, konstatimeve dhe dokumente të ndryshme për subjektet afariste pagesa është20.00 €.

2. DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME**Tarifat e taksave administrative për dokumente**

13.1.	Emërtimi i shërbimeve	Tarifa
1.	Certifikatë e lindjes	1.00 €
2.	Certifikatë e martesës	1.00 €
3.	Certifikatë e vdekjes	1.00 €
4.	Dëshmia e vdekjes (Për trashëgimi)	5.00 €
5.	Certifikatë e vendbanimit	1.00 €
6.	Deklaratë e Ushqimit për vitin Kalendarik (Dokument për jashtë shtojer)	5.00 €
7.	Certifikatë për gjendjen familjare (shtesa për fëmijë)	3.00 €
8.	Certifikatë e shtetësisë	2.00 €
9.	Ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civile	1.00 €

Tarifat e ngarkesave për shërbime tjera

13.2.	Emërtimi i shërbimeve	Tarifa
1.	Të vërtetuarit autentik të dokumenteve (për faqe)	1.00 €
2.	Deklaratë për bashkësinë familjare	5.00 €
3.	Certifikatë e gjendjes martesore	2.00 €
4.	Regjistrimi me vonesë në RTHL (Regjistri themeltar i të lindurve)	3.00 €
5.	Përkthimi dhe vërtetimi i dokumentit	3.00 €
6.	Vërtetim – sqarimi etj. (për nevoja jashtë vendit)	5.00 €
7.	Anulimet, korigjimet e gabimeve në RTHL	5.00 €
8.	Korigjimi i emrit dhe mbiemrit personal	5.00 €
9.	Ndërrimi i emrit ose mbiemrit	20.00 €
10.	Ceremonia e martesës gjatë orarit të punës	5.00 €
11.	Ceremonia e martesës jashtë orarit të punës	10.00 €
12.	Ceremonia e martesës jashtë ndërtesës	20.00 €
13.	Zhvillimi i procedurës për vërtetimin e ekzistimit të martesës	7.00 €
14.	Ceremonia e martesës me shtetësi tjetër	30.00 €
15.	Pjesëmarrja në tender për dhënien e vijave për autobus dhe kombibus	3.00 €
16.	Regjistrimet me vonesë në RTHV	3.00 €
17.	Vërtetim i ç'lajmrit të vendbanimit	1.00 €
18.	Vërtetim nga Arkivi	1.00 €
19.	Pranimi i kërkesave, ankesave dhe parashtresave	1.00 €
20.	Regjistrimi i lindjeve, vdekjeve, martesave ,që ndodhin jashtë vendit	5.00 €

13.3. Dispozitat ndëshkuese dhe gjobat në rastet e regjistrimeve me vonesë aplikohen sipas Ligjit për Gjendjen Civile , Ligji Nr.04/L-003

1. Mos paraqitja në afatin ligjor e regjistrimit të lindjes 20.00 € deri 50.00 €
2. Mos paraqitja në afatin ligjor e regjistrimit të vdekjes50.00 € deri 100.00 €

13.4. Këto dispozita ndëshkuese zbatohen për kohën para vitit 2000 kur ekzistojnë regjistrat Themeltar, ndërsa nga viti 2000 për rastet kur nuk kanë ekzistuar regjistrat Themeltar dhe janë krijuar regjistra të ri.

13.5. Nga pagesa e taksës për lëshimin e çertifikatave dhe dokumenteve zyrtare sipas nenit 13 të kësaj Rregulloreje, duke dëshmuar kopjen e dokumentit përkatës, janë të liruarat kategoritë si në vijim:

1. Asistencës sociale,
2. Familjet e ngushta të dëshmorëve,
3. Invalidët e luftës,
4. Veteranët e luftës,
5. Familjet e ngushta të viktimave civile dhe të zhdukurve të luftës,
6. Viktimat e dhunës seksuale të luftës,
7. Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik ,të verbërit ,dializës, dhe me aftesi te kufizuara
8. Studentët,

Neni 14

3. DREJTORIA PËR EKONOMI, FINANCA DHE BUXHET

4.

Tarifat e ngarkesave vjetore për veprimtaritë e shoqrive tregtare Bujqësia, industria, ndërtimtaria

14.1.	Kultivimi i kulturës së drithrave, pemëve dhe perimeve, hortikultura, Këpurdhave, rritja e bagëtive, shpendëve në ferma, gjuetia, peshkimi, veprimtarive, prodhimi ambalazheve e tjera të ngjashme	Tarifa vjetore 10.00 €
14.2.	Eksplotimi në miniera i thëngjillit, zhavorit, rërës, gurit gëlqeror e xeheve tjera të ngjashme klasifikimit standard tëveprimtarive	Tarifa vjetore 1500.00 €
14.3.	Prodhimi i produkteve të qumështit, përpunimi dhe konzervimi i mishit dhe produkteve të mishit, e të ngjashme, sipas klasifikimit standard të veprimtarive	Tarifa vjetore 100.00 €
14.4.	Prodhimi i miellit, mullinjtë elektrik, pijeve, duhanit e të ngjashme.	Tarifa vjetore 100.00 €
14.5.	Prodhimet prej druri i dyerve, dritareve, mobileve, botimi i librave, riprodhimi i disqeve sonore, prodhimi i preparateve farmaceutike, parfumeve, sapuni dhe preparateve kozmetike e të toaletit, produkteve prej gome dhe plastike, prodhimi i produkteve të qelqit, pllakave prej qeramikës, prodhimve prej mermeri, tjegullave, tullave, prodhime me beton bllokave, kubëzave, prodhimi e metaleve dhe produkteve, dritareve, portave metalike dhe nga plastika, prodhimi i makinave dhe pajisjeve e të ngjashme, sipas të klasifikimit standard të veprimtarive.	Tarifa vjetore 200.00 €
14.6.	Prodhimi : a) i tekstilit, lëkurës, b) betonit dhe asfaltit e të ngjashme në uzina e prodhime tjera.	Tarifa vjetore 10.00 € 500.00 €
14.7.	Rikuperimi i mbeturinave dhe hedhurinave metalike dhe jometalike.	Tarifa vjetore 50.00 €

14.8.	Furnizimi me gas e të ngjashme; a) Me pakicë b) Me shumicë	0.00 € 300.00 €
14.9.	Ndërtim objekteve , ndërtimi i rrugëve, kanalizimit, ujësjellësit,objekteve sportive, tarsave lumore e të ngjashme, sipas të klasifikimit standard të veprimtarive	Tarifa vjetore 300.00 €
14.10.	Meremetimi i ndërtimeve si lysterja, meremtimi i objekteve dhe pjesëve të tyre, vendosja e instalimeve dhe pajisjeve e të ngjashme, sipas të klasifikimit standard të veprimtarive;	Tarifa vjetore 100.00 €

Tregtia

14.11.	Ndërmjetësimi në tregtinë me shumicë të automjeteve motorike, makinave, pajisjeve, apartave, tekstilit, porcelonit dhe produkteve tjetra përveç tregtisë së makinave bujqësore, farërave, plehrave, barërave mjekësore dhe mallrave ushqimore.	Tarifa vjetore 500.00 €
14.12.	Tregtia me pakicë sipas pikës 14.11	Tarifa vjetore 300.00 €
14.13.	Tregtia me pakicë e materialit ndërtimor dhe drurit, e plehrave dhe farërave.	Tarifa vjetore 300.00 €
14.14.	Tregtia jo e specializuar me shumicë e ushqimit, pijeve dhe duhanit	Tarifa vjetore 500.00 €
14.15.	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara ku shiten artikujt ushqimorë, pijet dhe duhani, si dhe mallra të ndryshme të imëta në kiosqe; a) Minimarketit dhe kioska fshat dhe qytet b) Qendrat tregëtare (supermarketet dhe të veshjeve)	Tarifa vjetore 0.00 € 700.00 €
14.16.	Tregtia me pakicë e preparateve bujqësore, preparative kozmetike, pijeve alkoolike e joalkoolike, e veshjeve (butiqet) etj.	Tarifa vjetore 200.00 €
14.17.	Tregtia me pakicë e barërave mjekësore (barnatoret)	200.00 €
14.18.	Tregtia me pakicë e tekstilit dhe tepihave:	Tarifa vjetore 200.00 €
14.19.	Tregtia me pakicë e mobilieve e orendive shtëpiake (sallonet e mobilieve):	Tarifa vjetore 200.00 €
14.20.	Tregtia me pakicë e aparateve elektrike, shtëpiake, radioaparateve dhe aparateve TV, artikujve të imët metalike dhe materialit instalues, pjesëve për makina dhe autopjesë:	Tarifa vjetore 200.00 €
14.21.	Tregtia me pakicë e karburanteve dhe derivative të naftës: a) Ne qytet dhe rrugët Rajonale b) Neper fshatra	Tarifa vjetore 200 € 50.00€
14.22.	<i>Tregjet javore</i>	

	a) tregu për automjete	Tarifa vjetore 100.00 €
	b) tregu i gjelbërt	Tarifa vjetore 200.00 €
	c) tregu i plaçkave	Tarifa vjetore 100.00 €
	d) tregu i kafshëve	Tarifa vjetore 100.00 €
	e) tregu i lëndëve drusore	Tarifa vjetore 100.00 €
14.23.	Tregtia me pakicë e produkteve tjera në dyqane të specializuara (këpucëve, libraritë, CD shopet, artikujve funeral, etj. të ngjashme):	Tarifa vjetore 20.00 €

Hotelet dhe Restorantet

14.24.	Hotelet dhe motelet me restorant;	Tarifa vjetore 200.00 €
14.25.	Restorantet për organizimin e dasmave, lokalet e natës;	Tarifa vjetore 500.00 €
14.26.	Restorantet	Tarifa vjetore 100.00 €
14.27.	Kafiteritë, ëmbëltoret, menzat dhe kuzhinat (gjellëtoret e hamburgerët), diskoklubet e të ngjashme;	Tarifa vjetore 100.00 €
14.28.	Çajtoret;	Tarifa vjetore 10.00 €

Transporti tokësor

14.29.	Transporti i rregullt i udhëtarëve me autobusë dhe kompanitë e taksive	Tarifa vjetore 150.00 €
14.30.	Transporti i udhëtarëve me kombibuse	Tarifa vjetore 10.00 €
14.31.	Transporti i udhëtarëve me autotaksi	Tarifa vjetore 10.00 €
14.32.	Transporti i mallrave, rërës dhe materialeve tjera për ndërtim:	
	a) me maune dhe ndërmarrja transportuese, autotransportues (kamion)	Tarifa vjetore 100.00 €

Veprimtaritë përcjellëse dhe shërbyese

14.33.	Shërbimet bankare monetare dhe kredituese (filialet e bankave);	Tarifa vjetore 1500.00 €
14.34.	Shërbimet e ndërmjetësimit mikrofinanciar;	Tarifa vjetore 1000.00 €
14.35.	Shërbimet e telefonisë mobile, të postës dhe ato kablove	Tarifa vjetore 500.00 €
14.36.	Kontrollimi dhe analizat teknike;	Tarifa vjetore 200.00 €
14.37.	Veprimtaritë e fotografisë;	Tarifa vjetore 50.00 €
14.38.	Ndërmarrjet publike: të pastrimit të qytetit, ujësjellësit, pyjore, banesore	Tarifa vjetore 800.00 €
14.39.	Distributorët e energjisë elektrike	Tarifa vjetore 2000.00 €
14.40.	a) Veprimtaritë e agjencioneve të udhëtimit dhe shërbimet tjera për turistë, veprimtaritë e sigurimit të pasurisë dhe personave, parkingjet e automjeteve. b) Transeferet monetare	Tarifa vjetore 200.00 € 100.00 €
14.41.	Shërbimet e fitnesit, bilardot e të tjera që ushtrohen brenda	Tarifa vjetore 20.00 €
14.42.	a) Shërbimet e internetit, b) Tërenet për sporte (sallat), pishinat e të ngjashme	Tarifa vjetore 100.00 € 50.00 €
14.43.	Dhënia me qira e makinave, aparteve, skeleve, puna sezonale me makina bujqësore, kombajnerët e të ngjashme, pastrimi kimik i rrobave (tekstileve), fotokopjet dhe veprimtari tjera shërbyese të pa përcaktuara.	Tarifa vjetore 100.00 €

Arsimi, veprimtaritë profesionale dhe mbrojtja shëndetsore

14.44.	Veprimtaritë e shkollave për shofer (autoskollat)	Tarifa vjetore 200.00 €
14.45.	Organizimi i kurseve të gjuhëve , kompjuterit, kurseve plotësuese për aftësim në lëndët e ndryshme, arsimimin e të rriturve me pagesë e të ngjashme;	Tarifa vjetore 30.00 €
14.46.	a) Avokatët, përkthyesit, b) Noterët,	Tarifa vjetore 100.00 € 400.00 €
14.47.	Konsulentët financiar (kotabilistët), punët juridike pa përfaqësim;	Tarifa vjetore 100.00 €
14.48.	Stacionet lokale të radios;	Tarifa vjetore 30.00 €
14.49.	Stacionet lokale me TV;	Tarifa vjetore 50.00 €
14.50.	Shërbimet specialiste në ordinancë private.	Tarifa vjetore

		200.00 €
14.51.	Poliklinikat, qendrat diagnostike, laboratorët e analizave	Tarifa vjetore 200.00 €
14.52.	Shërbimet specialistike private njëditore në javë	Tarifa vjetore 50.00 €

Zejtaria

14.53.	Frizerët për mashkuj, këpucëtarët, orëtarët, rrobaqepësit etj;	Tarifa vjetore 100.00 €
14.54.	a)Vullkanizerët, b)Autolarjet, mekanikët e rtv, elektromekanikët e apartave dhe pajisjeve të amvisnisë, furrëtarët, burekgjinjtë; ,salduesit,autongjyroses,autoelekticist	Tarifa vjetore 100.00 € 10.00 €
14.55.	a) Sallonet e ondulimit për femra,	Tarifa vjetore 200.00 €
14.56.	Artarët, argjendarët;	Tarifa vjetore 200.00 €

14.57. Taksa Komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste përcaktohet në bazë të aktivitetit primar të regjistruar në ARBK.

14.58. Subjektet afariste, apo ndërmarrjet e të gjitha llojeve, të cilat e kanë selinë bazë në

territorin e Komunës së Malishevës, ndërsa të njejtën e ushtrojnë në vende të ndryshme në formë të njësive apo përfaqësive afariste në territorin e komunës, obligohen për secilën njësi punuese në shkallën 30% të tarifës bazë.

14.59. Shoqëritë tregtare të cilat selinë bazë e kanë në komunat tjera të Kosovës, e që në territorin e Komunës së Malishevës kanë të hapur njësitë apo përfaqësitë e tyre, ngarkohen me tarifën bazë të llojit të veprimtarisë.

14.60. Nga taksat komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste lirohen bizneset që regjistrohen për herë të parë për atë periudhë të mbetur të vitit fiskal në të cilin bënë regjistrimin

14.61. Lirohen nga taksat komunale për ushtrimin e veprimtarisë së tyre Bashkësitë fetare dhe Organizatat jo qeveritare (OJQ) në ushtrimin e aktivitetit ekonomik me qëllim të mbështetjes së aktivitetit të saj jofitimprurës.

14.62. Përfshihen nga pika 16.64 organizata jo qeveritare të cilat lëshojnë kredi me kamata fitimprurëse si intitucione mikro financiare.

14.63. Komuna i dërgon njoftimin (aktvendimin) për pagesën e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste shoqërive tregtare deri më 30 prill të vitit aktual.

14.64. Pagesa mund të bëhet në dy këste (kësti i parë deri me 30 qershor, i dyti deri me 31 dhjetor)

Neni 15

4. DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Renta për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës komunale

15.1.	Renta për eksploatimin dhe shfrytëzimin me gropim të pasurive tokësore e nëntokësore në pronësi të komunës: gurit, xheve, thëngjillit, zhavorit, rërës e të ngjashme për afarizëm;	Tarifa për m ³	1.50 €
15.2.	Shfrytëzimi i përkohshëm me ndërtime të forta për banim apo afarizëm;	Tarifa për m ²	4.00 €
15.3.	Shfrytëzimi i sipërfaqeve publike me vendosjen e kiosqeve, objekteve tjera prej montazhi në të cilat kryhet veprimtaria afariste;	Tarifa për m ²	3.00 €
15.4.	Dhënia e pronës komunale në shfrytëzim për qëllime prodhuese industriale;	Tarifa për m ²	0.50 €
15.5.	Qiraja joprofitabile për shfrytëzimin e objekteve të banimit social për	m ²	0.10 €
15.6	Dhënia e pronës komunale në shfrytëzim për afarizëm PA NDERTIM	m ²	1.00 €
15.7	Dhënia e pronës komunale në shfrytëzim për qëllime bujqësore	m ²	0.10 €

Neni 16

Shfrytëzimi i hapësirave në tregje publike në pronësi të Komunës

16.1.	Shfrytëzimi i hapësirave në tregun e gjelbërt, të plaçkave, kafshëve e tregje tjera javore:		
a)	për tavolinë shërbyese,	Tarifa ditore	1.00 €
b)	për automjet (veturë, kombi),	Tarifa ditore	1.50 €
c)	për kamion,	Tarifa ditore	3.00 €
d)	për kafshë të imta,	Tarifa ditore	0.30 €
e)	për kafshë të trasha.	Tarifa ditore	0.50 €
16.2.	Vendosja e tendeve të hapura lëvizëse për shitjen e gjërave të imëta, aparateve për akulllore, kafe, pije freskuese, librave jo shkollore etj. të ngjashme;	Tarifa ditore për m ²	1.00 €
16.3.	Ekspozimi i panove (pllakateve) reklamuese për biznes në brezin e rrugëve, pjesën anësore të trotuareve (që nuk paraqesin pengesë për këmbësorët) e hapësira tjera publike në qytezë (përveç atyre që janë të ngjitura në harmoni (linjë) me murin e objektit);	Tarifa vjetore për reklamë (pano)	30.00 €
16.4.	Vendosja e tavolinave shërbyese jashtë lokalit afarist në prona publike ;	Tarifa mujore për tavolinë	5.00 €
16.5.	Ngarkesa në marrjen e automjeteve në vendet e ndaluara nga komuna;	Tarifa për çdo automjet	5.00 €
16.6.	Pagesa për një vijë urbane nga kompanitë e transportit rrugor të udhëtarëve në territorin e Komunës	Tarifa	10.00 €

16.7.	Kompanitë e transportit rrugor të udhëtarëve , të cilët kanë më shumë se një vijë urbane pagesa bëhet duke llogaritur çdo vijë	Tarifa për vijë 10.00 €
16.7.(a)	Licenca për Transportues Urban	Tarifa 20.00 €
16.7.(b)	Licenca për Autotaksi	Tarifa 10.00 €
16.7.(c)	Pagesa për parkimin e rezervuar për Taxi, shuma vjetore	Tarifa 55.00 €
17	a)Caktimi i tarifave për grumbullimin e mbeturinave b)Grumbullimi i mbeturinave behet nga organet kompetente Komunale	
17.1	Amvisëritë: -Amvisëritë urbane dhe rurale	5.50 €
17.2	Dyqanet e vogla artizanale dhe shërbyese: -Kioska, kafe pjekse, shitore, shitës të CD dhe kasetave, argjendari, orëtar, agjenci turistike, avokatura, videolojra, videoklub, internet kafe, rrobaqepës, këpucëtar, dyqan fotografish, pastrim kimik, kozmetik, optika, gurgdhendës, mbathtar.saraq, zyra te inkasimit, përfaqësi të shoqatave, shitore suveniresh, këmbimore, librari, objekte religjioze, veprimtari tjera të ngjashme.	6.50 €
17.3	Subjektet e mesme dhe ato te mëdha komerciale/industriale kosto të ulët të shërbimit: -Autolarje, autoparking, kurse të gjuhëve të huaja dhe IT, pompa të derivateve, zyre postare, pemëshitës dhe minimarkete, auto pjese, butikët, shitore tekstili, hekrari, shitore sanitarie, mobileri, barnatore, bodrume të pijeve, zyre të partive politike, byrektore, ëmbëltore, floktar dhe veprimtari të ngjashme	8.00 €
17.4	Subjektet e mëdha komerciale/industriale dhe institucione të shërbyer me kontrata të veçanta -Poliklinikat dhe spitalet private, selit (telekom,sigurime bankare) sallone te mëdha të sanitaris dhe qeramikës, sallone te mëdha të mobiljeve, shtëpi botuese, shtypshkronjat, qendrat tregtare, restaurante, hotelet (mbi 20 dhoma), motele, pompa të derivateve me restorant supermarkete të mëdha dhe veprimtari të ngjashme	Tarifa/Euro/Muaji Lloji i shërbimit- zbrazje 1.1 m3-7.1 m3 12-45 €

Neni 17

5. DREJTORIA PËR URBANIZËM

I. Për ndërtimin ose rrënimin e një ndërtese ose struktura të tjera brenda teritorit të komunës , vendosen taksa të ndryshme në bazë të sipërfaqes në të cilën ndodhet ose në të cilën do të ndërtohet ndërtesa ose struktura.

- Koeficienti i llogaritjes së taksës administrative kategoria I dhe II për lëshimin e:

- a) Lejës së ndërtimit do të jetë 1.70 €/ m², ndërsa për
- b) Rregullimin e Infrastrukturës denzitetit do të jetë 151.08 € , për kokë banori të cilat llogariten sipas udhëzimit administrativ dhe jepen në tabelën e shpenzimeve.
- c) Leja e rrënitimit 5.00 €
- d) Vendimi për vazhdimin e Lejës ndërtimore 10.00 €
- e) Miratimi i vendimeve dhe pëlqimeve 5.00 €
- f) Vërtetimet sipas Planit Zhvillimor Komunal (lloji i destinimit të tokës) 20.00 €
- g) Taksa ndërtimore për ndërtimin e shtallave bujqësore 1.00 €/m²
- h) Taksa për kanal gjermim dhe punë tjera 0.50 m³

II. Taksa për dhënien e Lejës Mjedisore sipas udhëzimit administrative MMPH nr. 01/2017 për dhënien e Lejes Komunale Mjedisore;

- a) Leja mjedisore komunale për projekte në vlerë investive deri 25,000.00 € - Taksa 50.00 €.
- b) Leja mjedisore komunale për projektin në vlerë investive mbi 25,000.00 € - Taksa 0.2 % e vlerës së projektit.

III. Taksa e legalizimit në bazë të Ligjit Nr.04/L-188 për trajtimin e ndërtimeve pa leje

- a) Taksa për legalizim për shtëpi është një euro për metër katrorë (1€/m²)
- b) Taksa për legalizim për objekte komerciale është dy euro për metër katrorë(2€/m²).

Neni 18

6. DREJTORIA PËR GJEODOZI DHE KADASTËR

18.1. Taksat e Drejtorisë për Gjeodozi dhe Kadastër janë të përcaktuara në bazë të Udhëzimeve Administrativ (MEA) Nr.09/2020 për tarifën e shërbimeve të drejtave të pronës së paluajtshme, Udhëzimit administrativ (MMPHI) Nr.05/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e UA (MEA) nr.09/2020 për tarifën e shërbimeve për regjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtshme dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 12/19. për Ndarjen dhe Regjistrimin e Parcelës.

18.2. Këto Udhëzime Administrativ janë unike dhe zbatohet nga të gjitha zyrat komunale kadastrale, në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Regjistrimi i të drejtës së pronësisë në bazë të vlerës së transaksioneve

18.3. Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas vlerës së transaksionit është:

1. deri në dhjetëmijë (10.000) euro është tridhjetë (30) euro:
2. prej dhjetëmijë e një (10.001) euro deri në pesëdhjetë (50.000) euro është (50) euro:
3. prej pesëdhjetëmijë e një (50.001) euro deri në njëqindmijë (100.000) euro është shtatëdhjetë (70) euro:
4. prej njëqindmijë e një (100.001) euro deri në dyqindmijë (200.000) euro është nëntëdhjetë (90) euro:
5. prej dyqindmijë e një (200.001) euro deri në pesëqindmijë (500.000) euro është njëqind e njëzet (120) euro:
6. prej pesëqindmijë e një (500.001) euro deri në një milion (1.000.000) euro është dyqind e katër dhjetë (240) euro:
7. mbi vlerën e një milion (1.000.000) euro, tarifa është pesëqind (500) euro:
8. për vlerën e kontratës - transaksionit që është vërtetuar para vitit 1999 tarifa është pesëdhjetë (50) euro:
9. Tarifat e përcaktuara nga paragrafi I i këtij neni, zbatohen në të gjitha rastet kur nuk është e përcaktuar me dispozitë të veçantë tarifa për regjistrimin:

Tarifa e regjistrimit të pronësisë, në bazë të kontratës mbi dhuratën

18.4. Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës së dhurimit për anëtarin e familjes është tridhjetë (30) euro;

1. tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës së dhurimit për personin që nuk është anëtar i familjes dhe nuk është caktuar vlera e pronës tarifa është tetëdhjetë (80) euro;
2. Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës për dhurimin e pronës së paluajtshme, në të cilën është caktuar vlera e pronës dhe dhuratëmarrës nuk është anëtar i familjes zbatohet tarifa sipas nenit 5 të këtij Udhëzimi Administrativ.

Tarifa e regjistrimit të pronësisë, në bazë të kontratës mbi mbajtjen e përhjetshme

18.5. Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës së mbajtjes së përhjetshme për personin që është anëtar i familjes është tridhjetë (30) euro për çdo pronarë.

1. Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës së mbajtjes së përhjetshme për personin që e caktuar vlera pronës tarifa është tetëdhjetë (80) euro.

2. Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës për mbajtjen e përjetshme, në të cilën është caktuar vlera e pronës dhe mbajtjes nuk është anëtar i familjes zbatohet tarifa sipas nenit 5 të këtij Udhëzimi Administrativ.

Tarifa e regjistrimit të pronës apo të drejtave tjera sendore në bazë të titullit juridik të organeve administrative dhe gjyqësore

- 18.6. Tarifa për regjistrimin e të drejtës së pronësisë mbi pronën e paluajtshme apo të drejtave tjera sendore në bazë të vendimit të organit administrativ apo gjyqësor është tridhjetë (30) euro për çdo pronar.

Tarifa për regjistrimin e bashkëpronësisë apo pronësisë së përbashkët

- 18.7. Tarifa për regjistrimin e të drejtës në bashkëpronësi apo pronësi të përbashkët për bashkëpronarin apo pronarin e përbashkët është tridhjetë (30) euro.

1. Tarifa për regjistrimin e të drejtës në pronësi të përbashkët për bashkëshortet është tridhjetë (30) euro për një titull juridik.
2. Tarifa për regjistrimin e njësisë kadastrale si pjesë e ndërtesës është njëzet e pesë (25) euro për njësi.
3. Lirohet nga tarifa për regjistrimin e pronësisë së përbashkët të ndërtesave kolektive në bashkëpronësi.
4. Lirohet nga tarifa për regjistrimin e hapësirave të përbashkëta si njësi të veçanta.

Tarifat e regjistrimit të ndarjes së bashkëpronësisë apo pronësisë së përbashkët

- 18.8. Tarifat për regjistrimin e pronësisë në bazë të ndarjes nga bashkëpronësia apo pronësia e përbashkët për secilin bashkëpronar që bëhet pronarë individual është tridhjetë (30) euro.
- 18.9. Lirohet nga tarifa për regjistrimin e ndarjes nga bashkëpronësia sipas nenit 6 parag. 1 dhe 4 i Udhëzimit Administrativ Nr. 12/19 për Ndarjen dhe Regjistrimin e Parcelës.

Tarifat e regjistrimit të pronësisë në bazë të trashëgimisë dhe të shkëputjes së bashkësisë familjare

- 18.10. Tarifa për çdo trashëgimtar për regjistrimin e pronësisë në bazë të trashëgimisë është dhjetë (10) euro.
1. Tarifa për çdo trashëgimtar për regjistrimin e pronësisë në bazë të trashëgimisë, e cila rrjedh nga testamenti është njëzet (20) euro.
 2. Tarifa për regjistrimin e pronësisë në bazë të shkëputjes së bashkësisë familjare për çdo anëtarë të familjes që bëhet pronar është njëzet (20) euro.
 3. Tarifa për regjistrimin e njësisë kadastrale të krijuar nga ndarja apo bashkimi është njëzet (20) euro.

Tarifat e regjistrimit të pronësisë në bazë të ndërrimit/këmbimit të pronës së paluajtshme

18.11. Tarifa për regjistrimin e pronësisë në bazë të ndërrim-këmbimit të pronës së paluajtshme për secilin pronar është katër dhjetë (40) euro.

Tarifa për regjistrimin e të drejtës së shfrytëzimit-qirambajtja

18.12. Tarifa për regjistrimin e të drejtës së shfrytëzimit – qirambajtjes për çdo njësi kadastrale, kur pronar është Qeveria apo Komuna, me kohëzgjatje deri në 10 vite është dhjetë (10) euro.

1. Tarifa për regjistrimin e të drejtës së shfrytëzimit-qirambajtjes për çdo njësi kadastrale, kur pronar është Qeveria apo Komuna, me kohëzgjatje prej (10) vite deri në katërdhjetë(40) vite është tridhjetë (30) euro.
2. Tarifa për regjistrimin e të drejtës së shfrytëzimit- qirambajtjes për çdo njësi kadastrale, kur pronar është Qeveria apo Komuna, me kohëzgjatje prej katërdhjetë vite deri në nëntëdhjetë e nëntë (99) vite është pesëdhjetë (50) euro.
3. Tarifa për regjistrimin e qirasë nga personi fizik apo juridik në kohëzgjatje deri në dhjetë (10) vite për çdo njësi kadastrale është dhjetë (10) euro.
4. Tarifa për regjistrimin e qirasë nga personi fizik apo juridik në kohëzgjatje mbi dhjetë (10) vite për çdo njësi kadastrale është njëzet (20) euro.
5. Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit – Qirambajtjes për pronat e privatizuara nga ish Ndërmarrjes Shoqërore, me kohëzgjatje prej nëntëdhjetë e nëntë vite (99), bëhet duke zbatuar tarifën e përcaktuar sipas nenit 5 të këtij Udhëzimi Administrativ.

Tarifat për regjistrimin e Hipotekës

18.13. Tarifa për regjistrimin e hipotekës sipas vlerës së kredisë të përcaktuar me komentimin e hipotekës është:

1. deri në tridhjetëmijë (30.000) euro është njëzet (20) euro:
2. prej tridhjetëmijë e një (30.001) euro deri në pesëdhjetëmijë (50.000) euro është tridhjetë (30) euro:
3. prej pesëdhjetëmijë e një (50.001) euro deri në njëqindmijë (100.000) euro është gjashtëdhjetë (60) euro:
4. prej njëqindmijë e një (100.001) euro deri në dyqindmijë (200.000) euro është nëntëdhjetë (90) euro:
5. prej dyqindmijë e një (200.001) euro deri në pesëqindmijë (500.000) euro është njëqind e njëzet (120) euro :

6. prej pesqindmijë e një (500.001) euro deri në njëmiljon (1.000.000) euro është dyqind e katërdhjetë (240) euro:
7. mbi vlerën e njëmilion (1.000.000) euro, tarifa është katërqind (400) euro.
8. Hipoteka e cila regjistrohet në dy apo më shumë ZKK, tarifa përpjesëtohet në mënyrë të barabartë.

Tarifa për modifikimin dhe fshirjen e hipotekës

18.14. Tarifa për modifikimin e hipotekës së regjistruar është dhjetë (10) euro.

18.15. Lirohet nga tarifa fshirja e hipotekës nga Regjistri.

Tarifa për regjistrimin, modifikimin dhe fshirjen e servitutit

18.16. Tarifa për regjistrimin e të drejtës së servitutit për secilën parcelë dominante apo person është tridhjetë (30) euro.

1. Tarifa për modifikimin e servitutit është dhjetë (10) euro.
2. Tarifa për fshirjen e servitutit nga Regjistri është (20) euro.

Tarifa për regjistrimin, modifikimin dhe fshirjen e barrave dhe ngarkesave tjera

18.17. Tarifa për regjistrimin e barrës në tatimin në pronën e paluajtshme është (20) euro

1. Lirohet nga tarifa regjistrimi i masës së sigurisë (masës së përkohshme) apo modifikimin e saj.
2. Tarifa për regjistrimin e vërejtjes sipas Ligjit për Regjistrin e të Drejtave të Pronës Paluajtshme është katër dhjetë(40) euro.
3. Tarifa për regjistrimin e ndalesës nga Përmbaruesi privat apo Gjykata në procedurë përmbarimore për secilën njësi kadastrale është tridhjetë (30) euro.
4. Tarifa për regjistrimin e vërejtjes të mbajtësit në pronën e paluajtshme të të mbajturit në momentin e lidhjes së Kontratës mbi mbajtjen e përjetshme është njëzet (20) euro.
5. Tarifa për modifikimin e barrës apo ngarkesës tjetër është (10) euro.
6. Lirohet nga tarifa fshirja e barrës apo ngarkesës tjetër.

Tarifa për korrjimin e të dhënave kadastrale

- 18.18. Tarifa për korrjimin e të dhënave kadastrale që konstatohet se janë regjistruar gabim si pasoj e dokumentacionit të dorëzuar nga palët është tridhjet (30) euro.
- 18.19. Lirohet nga tarifa për korrjimin e të dhënave kadastrale që konstatohet se janë regjistruar si pasoj e gabimit të ZKK apo AKK, si dhe të gjitha gabimet e konstatuara nga sistemet e mëparshme.
- 18.20. Lirohet nga tarifa për korrjimin e numrit identifikues "KCID" sipas detyrës zyrtare.

Tarifa për dhënien e informatave nga Sistemi i Informacioneve Kadastrale të Tokave të Kosovës nga ZKK-të janë:

- 18.21. Vërtetim që personi fizik ose juridik nuk posedon prona - tri (3) euro.
- 18.22. Certifikata e pronësisë (deri në dhjetë faqe shënime të shtypura) katër (4) euro.
- 18.23. Certifikata e pronësisë (mbi dhjetë euro shënime të shtypura) njëzet (20) euro.
- 18.24. Kopja e planit - katër (4) euro.
- 18.25. Kopje në formatin A3 me ortofoto (bardhë e zi) katër (4) euro.
- 18.26. Kopje në formatin A3 me ortofoto (kolor) pesë (5) euro.
- 18.27. Historiati për një njësi kadastrale - njëzet (20) euro.

Tarifat për bazën gjeodezike

- 18.28. Pikat trigonometrike - Koridnatat Y, X, H me përshkrim, pesë (5) euro.
- 18.29. Pikat lidhëse - Koordinata Y, X, H me përshkrim, katër (4) euro.
- 18.30. Pikat poligoniale - Koordinatat Y, X, H me përshkrim, tri (3) euro.
- 18.31. Pikat e nivelimit - Koordinatat Y, X, H me përshkrim, pesë (5) euro.
- 18.32. Pikat në linjë - Koordinatat Y, X, H, dy (2) euro.
- 18.33. Pikat e detajit Y, X një (1) euro.
- 18.34. Tarifat për të dhënat në formën digjitale
- 18.35. Parcela në formë digjitale (shpfile, dëg, gml, ili) deri në 1 ha sipas kërkesës së palës (pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar) dhjetë (10) euro për njësi.

18.36. Parcela në formë digjitale (shpfile, dëg, gml, ili) mbi 1 ha deri në 2 ha sipas kërkesës së palës (pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar) njëzet (20) euro.

18.37. Parcela në formë digjitale (shpfile, dëg, gml, ili) mbi 2 ha deri në 5 ha sipas kërkesës së palës (pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar) katërdhjetë (40) euro.

18.38. Parcela në formë digjitale (shpfile, dëg, gml, ili) mbi 5 ha sipas kërkesës së palës (pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar) gjashtëdhjetë (60) euro.

18.39. CD - kompakt disku zero euro e pesëdhjetë cent (0.50).

Ndrrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë (sipërfaqe) për ndërtim

18.40.	Emërtimi i shërbimeve	Tarifa m ²
	a) për klasët e tokës 1 - 4,	1.00 €
	b) për klasët e tokës 5 - 6,	0.70 €
	c) për klasët e tokës 7 - 8,	0.50 €
18.41.	Lirohen nga pagesa e taksës në regjistrim të gjitha mjetet dhe pajisjet bujqësore.	

Neni 19

7. DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE PYLLTARI

Me qëllim të përkrahjes të lëmit të bujqësisë dhe ndihmës për bujqit Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari nuk aplikon tarifa për shërbimet e saj për bujqit.

Neni 20

8. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENJE SOCIALE

Tabela e shërbimeve për personat jashtë vendit

20.1.	Emërtimi i shërbimit	Tarifa
1.	Plotësimi i formularëve për shtesa fëmimore për Botën e Jashtme, (Adm.)	5.00 €
2.	Certifikata e statusit familjar për Itali,	5.00 €
3.	Certifikata e mbajtjes së anëtarit të familjes për Itali,	5.00 €
4.	Plotësimi i formularëve që përfshijnë në jetë, që marrin pensione në Botën e jashtme,	3.00 €
5.	Plotësimi i vërtetimeve për shtojer Gjermani,	5.00 €

6.	Vërtetim për pushim mjekësor në Botën e Jashtme,	5.00€
7.	Vërtetim për rregullimin e pensioneve në Botën e Jashtme,	5.00 €
8.	Plotësimi dhe rregullimi i formularëve, që është student që i nevojitet për Botën e Jashtme,	0.00 €
9.	Rregullimi i formularëve për shpenzime të varrimit,	5.00 €
10.	Lëshimi dhe Plotësimi i vërtetimeve të ndryshme që nevojiten për rregullimin e dokumentacionit në Botën e Jashtme.	5.00 €

Për nenin 20.1 duhet te ceken cilat kategori lirohen nga pagesa

20.2.	Certifikatat shëndetësore	
1.	Certifikata shëndetësore për regjistrim në çerdhe ose kopshte fëmijësh,	10.00 €
2.	Certifikata shëndetësore për regjistrim në shkollë fillore, të mesme, të lartë, fakultet e nivele dhe shkolla tjera të shkollimit,	10.00 €
3.	Certifikata shëndetësore për regjistrim në shkolla të veçanta të të gjitha niveleve dhe shkolla të tjera për profesione të veçanta,	10.00 €
4.	Certifikata shëndetësore për punësim,	15.00 €
5.	Certifikata shëndetësore për punësim në vende me kushte të veçanta pune,	50.00 €
6.	Certifikata shëndetësore për punë profesionale në lëmin e komunikacionit,	50.00 €
7.	Certifikata shëndetësore për pajisje me patentë shofer për kategoritë: A1, A, B1, B, BE, M, L dhe T,	20.00 €
8.	Certifikata shëndetësore për pajisje me patentë shofer për kategoritë: C1, C, D1, D, C1E, CE, D1E dhe DE,	40.00 €
9.	Certifikata shëndetësore për vlerësimin e aftësive psiko-fizike të përgjithshme dhe të veçanta,	50.00 €
10.	Certifikata shëndetësore për vlerësimin e aftësisë së gjyqimit të drejtë,	50.00 €
11.	Certifikata shëndetësore për përcaktimin e shkallës së lëndimeve trupore dhe/ose psikike,	50.00 €
12.	Certifikata / libreza shëndetësore për vlerësimin e aftësive psiko fizike të sportistëve,	10.00 €
13.	Libreza shëndetësore për sportist profesional,	20.00 €
14.	Certifikata shëndetësore për aftësitë psiko-fizike të bashkëshortëve për adoptim të fëmijës,	50.00 €
15.	Certifikata shëndetësore për aftësinë shëndetësore fizike dhe psikike për pajisje me leje për armë,	50.00 €
16.	Certifikata (skeda) e vdekjes, në rastet kur ka nevojë për autopsi,	50.00 €
17.	Libreza sanitare.	20.00 €

Tabela e bashkëpagesave për shërbimet shëndetësore në nivel parësor

20.3.	Emërtimi i shërbimit	Tarifa
1.	Ekzaminimi mjekësor në punkt, QMF ose QKMF, pa analiza laboratorike ose pa procedura plotësuese diagnostike me aparaturë,	1.00 €
2.	Ekzaminimi specialistik në QMF, QKMF, me udhëzim të mjekut të familjes,	2.00 €
3.	Ekzaminimi specialistik në QMF, QKMF, pa udhëzim të mjekut të familjes,	4.00 €
4.	Ekzaminimi në shtëpi, për pos në rastet emergjente,	6.00 €
5.	Medikamenti nga lista esenciale, ofruar në barnatoret publike,	0.30 €
6.	Ultrazëri standard,	2.00 €
7.	Radiografia,	2.00 €
8.	EKG,	0.50 €
9.	Analizat laboratorike – vetëm hemogrami dhe urina,	1.00 €
10.	Analizat laboratorike (komplet),	3.00 €
11.	Caktimi i sheqerit në gjak me glikometër si pas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore,	1.00 €
12.	Audiogrami,	1.00 €
13.	Shpërlajra e veshit,	1.00 €
14.	Dhënia e injeksionit intramuskular në shtëpi, përpos në rastet emergjente,	1.00 €
15.	Dhënia e injeksionit intravenoz në shtëpi, përpos në rastet emergjente,	1.00 €
16.	Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrimi deri në shërim (vetëm në vizitën e parë),	3.00 €
17.	Trajtimi ditor me infuzione në institucionin shëndetësor,	1.00 €
20.	Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimi apo dokumenti tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore,	5.00 €
21.	Ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive etj.- për një orë.	25.00 €

Tabela e bashkëpagesave për shërbimet stomatologjike të nivelit parësorë –QKMF dhe QMF

20.4.	Emërtimi i shërbimit	Tarifa
1.	Vizitë e parë stomatologjike,	1.00 €
2.	RTG i dhëmbit,	1.50 €
3.	Mbushje e përherëshme me amalgamë,	4.00 €
4.	Mbushje e përherëshme me kompozitë,	5.00 €
5.	Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përherëshme (amalgamë apo kompozitë),	5.00 €
6.	Amputimi vital i pulpës me mbushje të përherëshme (amalgamë apo kompozitë),	6.00 €
7.	Extirpimi vital i pulpës me mbushje të përherëshme,	6.00 €
8.	Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përherëshme (me amalgamë apo kompozitë),	6.00 €

9.	Extirpimi mortal i pulpës me mbushje të përherëshme (me amalgamë apo kompozitë),	6.00 €
10.	Terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përherëshme,	6.00 €
11.	Rindërtimi konzervativ i dhëmbit me mbushje të përherëshme,	6.00 €
12.	Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës,	1.00 €
13.	Fluorizimi i dhëmbëve sipas seanceve,	1.00 €
14.	Vulosja e fisurave,	1.00 €
15.	Mënjanimi i depozitimeve të buta,	1.00 €
16.	Mënjanimi i depozitimeve të forta (heqja e gurëzve të dhëmbëve me ultratingull)	3.00 €
17.	Kiretazha e xhepave parodontal (një dhëmb),	1.00 €
18.	Nxjerrja e dhëmbit,	1.50 €
19.	Incizioni intra dhe ekstra oral,	1.50 €
20.	Heqja e kurorës me anë të prerjes,	1.00 €
21.	Riparimi i protezës (ngjitja).	1.50 €

20.5. Përfshihen nga lista e bashkë pagesave të gjitha shërbimet shëndetësore dhe grupet e veçanta të popullatës, në përputhje me nenin 22 të Ligjit për Shëndetësi Nr./2004.

20.6. Shërbimet shëndetësore dhe grupet e popullatës, të liruara nga bashkë pagesa janë:

- a) Fëmijët dhe të rinjtë deri në moshën 15 vjeçare,
- b) Nxënësit dhe studentët deri në fund të shkollimit të rregulltë,
- c) Qytetarët mbi moshën 65 vjeçare,
- d) Qytetarët, anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve, invalidët e luftës dhe llojet tjera të invaliditetit, anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre, si dhe shfrytëzuesit e skemave të përgjithshme sociale dhe anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre,
- e) Personat me aftësi të kufizuara,
- f) Kujdesi shëndetësor parandalues,
- g) Kujdesi shëndetësor reprodiktiv, që përfshinë masat e planifikimit të familjes dhe kujdesin gjatë shtatzënisë, lindjes dhe lehonisë,
- h) Kujdesi shëndetësor për qytetarin në stadin terminal duhet të ofrohet në shtëpinë e qytetarit nga ana e Qendrës së mjekësisë familjare.

Tabela e shërbimeve me pagesë në Qendrën për Punë Sociale (QPS)

20.7.	Emërtimi i shërbimit	Tarifa
1.	Vërtetimi për humbjen e shtetësisë së Kosovës,	25.00 €
2.	Vërtetimi për fitimin e shtetësisë së Kosovës,	20.00 €
3.	Vërtetimi që nuk i është hequr zotësia e punës dhe veprimit,	15.00 €
4.	Pëlqimi për martesë para moshës madhore,	20.00 €
5.	Kërkesë për regjistrim të më vonshëm të fëmijëve,	5.00 €
6.	Pëlqimi për përfaqësim në gjykatë për fëmijët për trashëgimi, nënshkrimi i kontratave të ndyshme dhe caktimi i kujdestarisë,	10.00 €
7.	Pëlqimi për udhëtim jashtë vendit për fëmijë, prindërit e të cilëve jetojnë ndaras jashtë shtetit,	5.00 €

8.	Anamneza sociale, (konstatimi gjendjes faktike),	
9.	Vërtetim që nuk është përfitues i ndihmës sociale (nga kjo tariflirohen: familjet që janë nën ndihmë sociale, familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës, nxënësit dhe studentët),	5.00 €
10.	Vërtetim që nuk merr ndihmë sociale	0.00 €

20.8. Personat dhe subjektet e liruar nga pagesa e tarifës në Drejtorinë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale dhe QPS-së:

1. Rastet sociale (dëshmia nga QPS),
2. Familjet e dëshmorëve të luftës (prindërit, bashkëshortja dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare),
3. Invalidët e luftës të shkallës së parë dhe të dytë (dëshmi nga organi kompetent),
4. Viktimat e luftës (prindërit, bashkëshortët dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare),
5. Personat me aftësi të kufizuara (dëshmi e invaliditetit të lëshuar nga organi kompetent),
6. Veteranët e luftës së UÇK-së (dëshmi kartela valide e veteranit),
7. Pensionistët, Shoqata dhe sindikata e pensionistëve,
8. Studentët,
9. Ish të burgosurit politik.

Neni 21

9. DREJTORIA PËR ARSIM DHE EDUKIM

- 21.1. Për provimet me korrespondencë kandidatët janë të obliguar të paguajnë**
- | | |
|------------------------|---------|
| 1. për paraqitje, | 20.00 € |
| 2. lënda me shkrim, | 0.70 € |
| 3. lënda pa shkrim, | 0.50 €, |
| 4. provimi i diplomës, | 15.00 € |
| 5. diploma duplikatë, | 1.00 € |
| 6. dëftesa duplicatë, | 1.00 € |
- 21.2. Për vijimin dhe përfundimin e arsimit dhe aftësimin për të rritur vijuesit do të paguajnë:**
- | | |
|--|----------|
| 1. për regjistrim të vitit, | 100.00 € |
| 2. për provimet përfundimtare të klasës, certifikatën, | 30.00 € |
| 3. për diplomë përfundimtare të shkollimit, | 20.00 € |
| 4. për praktikë profesionale, | 50.00 € |
| 5. për ndryshim të lëndëve deficitare, | 10.00 € |
| 6. lëndët me gojë. | 1.00 € |
- 21.3. Për një dokument duplikat të arsimit parauniversitar paguhet:**
- | | |
|--|--------|
| 1. Dëftesa duplikat për kryerjen e shkollës fillore dhe të mesme të ulët | 1.00 € |
| 2. Dëftesa duplikat për kryerjen e shkollës së mesme të lartë | 1.00 € |
| 3. Diploma duplikat për kryerjen e shkollës së mesme të lartë | 1.00 € |

21.4 Çerdhja për fëmijë

1. Për regjistrimin e fëmijës në Çerdhe paguhet tarifa mujore 50.00 €
2. Për fëmion e dytë të familjes së ngushtë për regjistrim paguhet tarifa mujore 25.00 €
3. Për fëmion e tretë të familjes së ngushtë për regjistrim – lirohet nga pagesa

Neni 22

10. DREJTORIA PËR KULURË, RINI DHE SPORT

Biblioteka e qytetit

22.1. Anëtarësimi vjetor i lexuesit në bibliotekën komunale „ Sokol Kryeziu ” në Malishevë

1. Nxënësi i shkollës fillore 1.00 €
2. Nxënësi i shkollës së mesme 2.00 €
3. Të rriturit 3.00 €

Shfryrëzimi i Palestrës së sporteve „Habib Zogaj”

22.2 Për shfrytëzimin e palestrës së sporteve, jashtë organizimeve që bënë Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Kuvendi i Komunës, nga subjekte tjerë të ndryshëm dhe qytetarët paguhet këto tarifa:

22.3.	Emërtimi i shërbimit	Tarifa
1.	Për stërvitje të klubeve private dhe stërvitje të lira sportive për një orë pa ndriçim	0.00 €
2.	Për stërvitje të njëjta për një orë me ndriçim	0.00 €
3.	Për zhvillimin e ndeshjeve mes klubeve për ndeshjen pa ndriçim	0.00 €
4.	Për zhvillimin e ndeshjeve mes klubeve për ndeshjen me ndriçim	0.00 €
5.	Për terminë tjera nga qytetarët për një orë pa ndriçim	10.00 €
6.	Për terminë tjera nga qytetarët për një orë me ndriçim	15.00 €

22.4. Për shfrytëzimin e palestrës së sportit për manifestime dhe ngjarje të ndryshme si:

1. Për ngjarje komerciale: panaire, revy, ekspozita dhe fushata të grupeve politike100 €
2. Për ngjarje humanitare: seminare edukative, akademi përkujtimore, fushata edukative popullore, evente humanitare të tjera shfrytëzimi i palestrës është gratis.
3. Te klubet që nuk janë të Komunës së Malishevës, të cilat për shkaqe të ndryshme janë të interesuara t'a shfrytëzojnë palestrën e sporteve në Malishevë për zhvillimin e takimeve (ndeshjeve) duhet të paguajnë për ndeshje tarifën 100.00 €

Shfryrëzimi i Shtëpisë së Kulturës „Tahir Sinani”

22.5. Për shfrytëzimin e shtëpisë së kulturës, jashtë organizimeve që bënë Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Kuvendi i Komunës, nga subjekte tjerë të ndryshëm dhe qytetarët paguhet këto tarifa:

	Emërtimi i shërbimeve	Tarifa
1.	Përrurime të Librave	0.00 €
2.	Ekspozita Artistike	0.00 €
3.	Koncerte dhe shfaqje të ndryshme	100.00 €
4.	Tubime Elektorale	100.00 €
5.	Akademi përkujtimore, aktivitete humanitare dhe organizime apo manifestime me karakter Kombëtar dhe të ngjashme janë të liruara nga pagesa	

II. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 23

23.1 Gjobat e shqiptuara për shkelje kundërvajtëse në trafik i takojnë komunës. Alokimi i mjeteve të inkasuara bëhet sipas dispozitave të rregullativës së Thesarit.

23.2 Mjetet e inkasuara mund të jenë si rrjedhojë e dënimeve mandatore, përmes Policisë së Kosovës dhe vendimeve përfundimtare të gjykatës kompetente.

Neni 24

Ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregullore pushon aplikimi i dispozitave të rregulloreve dhe vendimet tjera lidhur me tarifën, ngarkesat dhe gjobat komunale që kanë qenë në fuqi gjatë kohës së kalimit, ndërsa dispozitat tjera që kanë të bëjnë me procedurën dhe në rast se paraqiten mungesa juridike, do të veprohet në pajtim me udhëzimet administrative të Ministrive përkatëse.

Neni 25

Përshtatim nga neni 24 i kësaj Rregulloreje bëjnë; Rregullorja mbi tatimin në pronë, Rregullorja për Ngarkesat vjetore të regjistrimit të automjeteve.

Neni 26

Tabela e tarifave të kësaj Rregulloreje duhet të miratohet çdo vit gjatë kohës së kalimit nga Kuvendi i Komunës, për të pasur fuqi të plotë dhe legale në grumbullimin e të hyrave për komunën gjatë viti në vijim.

Neni 27

Tarifat për punët ditore administrative të kryera nga drejtoritë komunale gjatë kohës së kalimit në fuqi të kësaj Rregulloreje, kanë vlefshmëri të plotë, ashtu si janë vendosur me dispozitat e rregulloreve deri atëherë ekzistuese, ndërkaq tarifat vjetore caktohen sipas kësaj Rregulloreje.

Transparenca në taksa komunale

Neni 28

Kuvendi Komunal përditëson këtë Rregullore kurdo që Qeveria e Republikës së Kosovës apo ndonjë agjenci e pavarur ndryshon taksat ekzistuese qendrore apo përcakton ndonjë takes tjetër.

Neni 29

Ndryshimi dhe Plotësimi

Kjo Rregullore mund të ndryshohet dhe plotësohet në procedurë të njëjtë me atë të miratimit nga Kuvendi i Komunës së Malishevës me propozimet e arsyetuara nga propozuesit.

Dispozitat e kësaj rregulloreje vlejnë të njëjta për vitin/et, e ardhshëm/e, nëse nuk bëhen ndryshimet dhe plotësimet e normave të kësaj rregullore.

Neni 30

Kjo Rregullore gjithëherë duhet të harmonizohet me ligjet dhe udhëzimet administrative të miratuara nga Qeveria e Kosovës për nivelin e komunave

Neni 31

Zbatimi i Rregullores

Për zbatimin e kësaj rregullore kujdeset Kryetari i Komunës përmes drejtorive komunale

Shfuqizimi

Neni 32

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja nr.02/237 datë 13/05/2023 për Taksa ,Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2022

Publikimi dhe hyrja ne fuqi

Neni 33

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, kjo Rregullore hyn në fuqi sipas nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Rregullores (QRK) nr.10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me rregulloren (QRK) nr.06/2021, përkatësisht pas shpalljes në faqen zyrtare të Komunës së Malishevës.

KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Nr. 02/ _____

Datë ____/____/2023

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Argjend Thaçi

